

**V E N D I M**  
**Nr. 300, datë 27.6.2002**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.437, DATË 3.9.1993 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE "PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË TATIMEVE", ME NDRYSHIMET**  
**PËRKATËSE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2 e 6 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.437, datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave, me ndryshimet përkatëse, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, paga mujore për funksionet e mëposhtme bëhet:

Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

Këshilltar i plotfuqishëm, i ngarkuar për bashkërendimin

ndërmjet organeve të policisë tatimore dhe doganore 71900 lekë

b) Në pikën 2, paga mujore për funksionin e Zëvendësdrejtorit

të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve bëhet 53 600 lekë

c) Në pikën 3, niveli më i ulët i pagës bëhet 9 880 lekë në muaj, kurse niveli më i lartë (kryetar dege, drejtor drejtorie) bëhet 26 100 lekë në muaj.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga fondet e miratuara për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 16 korrik 2002.

**KRYEMINISTRI**  
**Pandeli Majko**